

VENDIM
Nr.39, datë 14.7.2006

PËR MOSFILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13, pika 1 germa d, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të nenit 9 të vendimit nr.37, datë 9.7.2004 “Rregullore për procedurat e licencimit”, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, me ndryshimet përkatëse, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.7.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Wonder Power” sh.a. për licencim në aktivitetin e eksportit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Mosfillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës për licencimin e shoqërisë “Wonder Power” sh.a., për aktivitetin e eksportit të energjisë elektrike.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta